

Skema e nëngrantimit është zbatuar në kuadër të projektit **“Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen,,** mbështetur nga Komisioni European

Zhvilluar në bashkëpunim me Instituti i Studimeve Politike dhe Civil Rights Defenders

Organizata zbatuese e nëngrantit: **Intelektualët e Rinj, Shpresë**

Zona e zbatimit: Shkodër

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është fuqizimi i të rinjve për të promovuar proceset demokratike të bazuara në komunitet dhe përfshirjen e qytetarëve për të siguruar integritetin e zgjedhjeve dhe transparencën politike.

Nëpërmjet zbatimit të kësaj nisme, synohet të arrihen objektivat e posaçëm:

1. Të forcohen kapacitetet e strukturave përfaqësuese rinore, organizatave të shoqërisë civile dhe rrjeteve rinore për të marrë pjesë në proceset zgjedhore duke u mundësuar atyre të rrisin llogaridhënien e partive politike dhe transparencën e programeve të tyre në qarkun e Shkodrës.
2. Të ndërgjegjësohen qytetarët për proceset zgjedhore duke nxitur pjesëmarrjen e tyre për të garantuar përgjegjshmërinë e partive politike dhe programe transparente.

Rezultatet të cilat synohen të arrihen nëpërmjet ndërmarrjes së aktiviteteve të planifikuara janë:

1. Rritja e ndikimit të strukturave përfaqësuese rinore dhe OShC-ve në procesin zgjedhor në Shkodër;
2. Rritja e numrit të qytetarëve/të rinjve pjesëmarrës në proceset zgjedhore në nivel vendor;
3. Rritja e nivelit të llogaridhënies së partive politike dhe transparencës së programeve të tyre që ndikojnë në pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset zgjedhore.